

Dr. Musli Vërbani

SINQERITETI

13

Kaçanik, 2011

Autor:
Dr. Musli VËRBANI

Titulli:
SINQERITETI

Korrektura:
Burim Bunjaku

*Radhitja kompjuterike,
kopertina dhe dizajni grafik*
Mumin Shehu

Botues: **Autori**

Shtypi:
“FokusPrint”

Të drejtën e ribotimit e rezervon autori

HJRJE

Shumica e njerëzve bëjnë ibadet formalisht dhe sa për sy e faqe. Kështu shohim se ka prej njerëzve, të cilët shkojnë herë pas here në xhami, falen, por bëhet pyetja: “A e falin atë namaz vetëm për Allahun, apo e falin vetëm e vetëm që ta shohin njerëzit se është njeri i namazit?”.

Po ashtu shohim njerëzit që japin sadaka para njerëzve, lavdërohen, krenohen dhe dëshirojnë që për ato punë të ngrihen lartë dhe të lavdërohen.

Po ashtu shohim njerëz, të cilët agjërojnë, mirëpo në të vërtetë prej agjërimit të tyre nuk përfitojnë asgjë, përpos etjes dhe urisë. Kjo nga shkakun se atë agjërim e bëjnë për syfaqësi, e jo vetëm për Allahun.

Po ashtu ka prej njerëzve, të cilët shkojnë në haxh vetëm për t’u lavdëruar dhe vetëm për ta marrë titullin haxhi. Mirëpo robi i vërtetë dhe i singertë kur ta bëjë një punë e bën vetëm për Allahun. Ai singeritetin e ka në zemër, tërë trupi, tërë shpirti i tij është i mbushur me singeritet.

Një natë Muhamedi s.a.v.s. ishte duke kaluar nëpër rrugët e Medinës, së bashku me të ishte Burejdete, duke ecur e dëgjojnë një të qajtur nga brendia e xhamisë. Në xhami një njeri falej, lexonte Kur’an dhe qante. Mirëpo pse qante nuk dihej, ndoshta prej frikës së xhehenemit, apo dëshirës për të hyrë në xhenet.

Besimtari duhet të jetë i singertë në fenë e tij, në jetën e tij, haptazi dhe fshehurazi.

Zoti i Lartmadhëruar në Kur’an i ka thënë Muhamedit s.a.v.s.:

“Thuaj: Unë jam i urdhëruar ta adhuroj Allahun me një adhurim të singertë ndaj Tij”.

(Ez-Zumer, 11)

Zoti i Lartmadhëruar ka urdhëruar që edhe ne besimtarët ta vazhdojnë rrugën e tij, që të jemi të singertë në adhurimet tona në fe.

“E duke qenë se ata nuk ishin të urdhëruar me tjetër, pos që ta adhuronin Allahun me një adhurim të singertë ndaj Tij, që të largohen prej çdo besimi të kotë, ta falin namazin, të japin zekatin, se ajo është feja e drejtë.”

(El-Bejine, 5)

SINQERITETI

Sinqueriteti do të thotë pastërti, çiltërsi dhe kthjelltësi, e kjo do të thotë që muslimani fjalët dhe veprat e tij t'i ketë posaçërisht vetëm për Allahun dhe për të fituar kënaqësi ndaj Allahut, e jo për reputacion, e as për t'u proklamuar, ai nuk vepron që ta shohin njerëzit e ta lavdërojnë.

Po ashtu sinqeritetet do të thotë pastërtia e zemrës nga çfarëdo njolle.

Disa dijetarë e kanë quajtur sinqeritetin kështu:

“Që ti ta bësh veprën e të mos e dijë askush tjetër, pos Allahut”.

Kjo cilësi vërtet është cilësi madhështore. Sinqeriteti në vepra e largon shejtanin dhe shejtani nuk mund të afrohet, dhe nuk mund të fusë dyshime në fjalë apo në veprime, sepse Zoti i Lartmadhëruar i ruan besimtarët e sinqertë nga shejtani: Zoti i Lartmadhëruar në Kur'an na ka treguar se si ka thënë Iblisi:

(Iblisi) Tha: “Zoti im, për shkak se më përzure (më largove), unë do t'ua zbukuroj (të këqijat) atyre sa të jenë në tokë (në këtë botë) dhe të gjithë ata do t'i largoj nga rruga e drejtë! Përveç robërve të Tu, të cilët i ke bërë të sinqertë.”

(El-Hixhr, 39-40)

E kundërta e sinqeritetit është dyfaqësia apo hipokrizia.

Sinqeriteti është shkëndijë, të cilën Zoti i Lartmadhëruar e vendos në zemrat e robërve të zgjedhur të Tij, që t'i ndriçojë, t'i pastrojë, t'i lulëzojë, t'i gjallërojë dhe t'i forcojë zemrat e tyre.

Sinqeriteti është kandari në të cilën maten burrat dhe peshojë në të cilën vendosen veprat.

Me sinqeritet besimtari e përsos besimin e tij.

Sinqeriteti bën që besimtari të japë vetëm për Allahun, të dojë vetëm për Allahun, të urren vetëm për Allahun, të pengojë vetëm për Allahun dhe të gjitha këto vetëm e vetëm për ta fituar kënaqësinë e Allahut.

Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

“Kush do vetëm për Allahun, urren vetëm për Allahun, jep vetëm për Allahun dhe nuk jep vetëm për Allahun, ai veç e ka plotësuar imanin e tij.”

Sinqeriteti është rruga, e cila e bën jetën të qetë, të lumtur dhe pa brenga. Sinqeriteti sjell furnizim me urdhrin e Allahut pa ndërprerë:

“Kush vepron mirë, qoftë mashkull apo femër dhe është besimtar, Ne do ta bëjmë që ai të jetojë një jetë shumë të mirë, dhe ata do t'i shpërblejmë shumë më shumë dhe më mirë se çka kanë punuar”.

(En-Nahl, 97)

Sinqeriteti është në kundërshtim me idhujtarinë; kush nuk është i sinqertë është idhujtar.

SINQERITETI NË KUR'AN

Zoti i Lartmadhëruar në Kur'an i ka thënë Muhamedit s.a.v.s.:

“Thuaj: Unë jam i urdhëruar ta adhuroj Allahun me një adhurim të singertë ndaj Tij”.

(Ez-Zumer, 11)

Zoti i Lartmadhëruar ka urdhëruar që edhe ne besimtarët ta vazhdojnë rrugën e tij, që të jemi të singertë në adhurimet tona në fe.

E duke qenë se ata nuk ishin të urdhëruar me tjetër, pos që ta adhuronin Allahun me një adhurim të singertë ndaj Tij, që të largohen prej çdo besimi të kotë, ta falin namazin, të japin zekatin, se ajo është feja e drejtë.

(El-Bejine, 5)

Besimtari duhet të pendohet, të përmirësohet të mbështetet tek Allahu dhe të ketë besim të singertë. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Por ata që pendohen, përmirësohen, mbështeten fort tek Allahu dhe që besimin e tyre e kanë singërisht vetëm për Allahun, do të jenë me besimtarët e vërtetë, Allahu do t’u japë shpërblim të madh besimtarëve”.

(En-Nisa, 146)

Të gjitha lutjet duhet t’i bëjmë lutje të singerta. Zoti i Lartmadhëruar në Kuran thotë:

“Andaj, luteni Allahun me adhurim të singertë për Të, edhe nëse këtë e urrejnë jobesimtarët.”

(El-Gafir, 14)

SINQERITETI NË HADITHË

Muhamedi s.a.v.s. ka thënë:

“Veprat shpërblehen sipas qëllimit. Çdo njeri shpërblehet për veprën e tij se për çka e ka vendosur ta bëjë atë vepër. Nëse hixhreti i ndonjërit është për Allahun dhe të Dërguarin e Tij, atëherë edhe shpërblimi i atij hixhretit bëhet shpërblim për Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Po nëse ndonjëri e ka bërë hixhretin që të përfitojë diçka në këtë botë apo për t’u martuar me ndonjë grua, atëherë edhe shpërblimi i atij hixhreti është për atë qëllim”.

(Mutefekun alejhi)

Transmeton Mus’ab bin Saidi nga babai i tij dhe thotë:

“Babai im ka paragjykuar se është më i vlefshëm në krahasim me shokët tjerë të Muhamedit s.a.v.s. Mirëpo, Muhamedi s.a.v.s. ka thënë:

“Vërtet Allahu ndihmon këtë umet (popull) me më të dobët të mesit të tij, nëpërmjet namazit dhe lutjeve të tyre të singerta.”

(Transmeton Nesaiju)

Thuëbani transmeton se ka dëgjuar Pejgamberin s.a.v.s. duke thënë:

“Lum për të singertit. Ata janë kandila të rrugës së drejtë, me të ndriçohet çdo errësirë, për të kaluar rrugën pa pengesë.”

(Transmeton Bejhekiu)

Sinqeriteti ndihmon për t’i arritur dëshirat dhe shpresat, sa do që të jenë të mëdha.

Transmeton Muadh bin Xhebeli se Muhamedi s.a.v.s. ka thënë:

“Bëhu i singertë në fenë tënde, të mjafton edhe puna më e vogël”.

(Hakimi)

Shpirti i çdo pune është sinqeriteti; çdo punë pa sinqeritet është i pavlefshëm dhe nuk sjell fryte fare, por zhduket, sikurse pluhurin kur e merr era.

“Kush kalon prej kësaj bote në botën tjetër duke qenë i singertë me Allahun, duke mos i bërë idhujtari Atij, e fal namazin, e jep zekatin, - ai ka vdekur duke qenë Allahu i kënaqur me të.”

(Ibn Maxhe dhe Hakimi nga Enes bin Maliki)

SINQERITETI I PEJGAMBERËVE

Të gjithë pejgamberët kanë qenë të sinqertë, në krye të të sinqertëve është Pejgamberi ynë Muhamedi s.a.v.s., i cili edhe ka kërkuar që të gjitha veprat t'i kryejmë me sinqeritet.

Zoti i Lartmadhëruar në Kuran përmend sinqeritetin e Musa a.s. ku thotë:

“Përkujto në libër (Kuran) edhe Musanë! Vërtet ai është i përzgjedhur, i sinqertë. Ishte i dërguar Pejgamber.”

(Merjem, 51)

Pastaj Kurani ka përmendur sinqeritetin e Ibrahimit, Is'hakut dhe Jaëkubit, ku thotë:

“Kujto robërit tanë: Ibrahimin, Is'hakun dhe Jaëkubin të fortë (në besim) dhe largpamës. Ne u dhuruam atyre një virtyt të veçantë që ta kenë gjithmonë në botën e ardhshme. Vërtet ata janë tek Ne, nga njerëzit më të mirë e më të zgjedhur.”

(Sad, 45-47)

Lusim Allahun që edhe ne të bëhemi të sinqertë dhe të pasojmë rrugën e më të zgjedhurve!

SUREJA E SINGERITETIT – SURETUL IHLAS

قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ (1) اللَّهُ الصَّمَدُ (2) لَمْ يَلِدْ وَلَمْ يُولَدْ (3)
وَلَمْ يَكُنْ لَهُ كُفُوًا أَحَدٌ (4)

(El-Ihlas, 1-4)

Në këtë sure përfshihen cilësitë e Allahut.

1. **Thuaj: “Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm!**
2. **Allahu është Absoluti, të Cilit i përgjërohet gjithçka në amshim.**
3. **Ai as nuk lind, e nuk ka lind, e as nuk është i lindur.**
4. **Dhe askush nuk është i barabartë (a i krahasueshëm) me Atë.**

Në kohën e Pejgamberit s.a.v.s. një njeri e ka dëgjuar se si një njeri tjetër e ka lexuar suretull Ihlal (suren e Singeritetit) në mbrëmje një herë, pastaj prapë e ka përsëritur dhe i është dukur se ka lexuar pak. Të nesërmen në mëngjes këtë ia tregon Pejgamberit s.a.v.s., ndërsa Muhamedi s.a.v.s. i thotë:

“Pasha Atë (Allahun) në dorën e të Cilit është shpirti im, kjo sure (suret Ihlal) është me vlerë sa një e treta e Kur’anit.”

Është e vërtetë se kjo sure ka vlerë të posaçme, sepse në të është njëshmëria e Krijuesit, pra është sureja e imanit të sigurtë në Allahun.

SI TA FITOJMË SINGERITETIN

Në një vendbanim jetonin dy njerëz: njëri quhej Muhsin, e tjetri Hamdan. Ata dallonin shumë njëri me tjetrin.

Muhsini punonte punë të mira në fshehtësi, punët e tij të mira nuk i shihte askush, përpos një numri të vogël të njerëzve. Edhe pse njerëzit përfitonin shumë të mira prej tij, ata nuk e dinin se ato të mira ishin si rezultat i Muhsinit.

Hamdani kur e bënte një punë të mirë e përhapte lajmin, tregohej e lavdërohej dhe dëshironte të lavdërohej.

Një ditë, gjatë namazit të xhumasë, imami e shpjegonte ligjëratën e singeritetit. Në mes tjerash ai tregonte se në Ditën e Kijametit shumë njerëz do të dalin para Allahut me të mira të shumta, por Allahu nuk do t'ua pranojë ato të mira, përkundrazi do t'i shpie në zjarr, sepse ata njerëz, ata të mira i kanë bërë për t'u lavdëruar dhe për t'u proklamuar para njerëzve.

Pas namazit Hamdani shkon te ligjëruesi dhe i thotë: “Cila është rruga për të arritur deri te singeriteti, që të m'i pranojë Allahu punët e mira?” Imami i thotë: “Nëse ke kohë, eja që të shkojmë në shtëpinë time që të bisedojmë për këtë çështje”. Muhsini, i cili ishte aty i thotë: “Po shtëpia ime është më afër, po shkojmë në shtëpinë time”. Pastaj shkuan në shtëpinë e Muhsinit.

Filloi biseda në mes Muhsinit dhe Hamdanit për çështjen e të fituarit të veçorisë së singeritetit dhe për faktorët, të cilët ndikojnë që njeriu të bëhet i singertë. Duke sqaruar imami, në mes tjerash, thotë:

“Për të qenë muslimani i singertë duhet pasur parasysh disa gjëra”. - Cilat janë ato? – pyeti Hamdani.

E para: Duhet ditur kuptimin e singeritetit, rëndësinë dhe domosdoshmërinë për jetë, dhe që ta dish se Allahu e ka bërë obligim adhurimin ndaj Tij, dhe çështjet tjera të jetës.

- Cili është përfitimi i singeritetit – pyeti Hamdani. Imami u përgjigj: “Singeriteti shpërblehet pa masë tek Allahu. A e di ti se singeriteti është shkaktar për të fituar shefaatin e të Dërguarit të Allahut s.a.v.s.

Një ditë prej ditëve Ebu Hurejre e pyet të Dërguarin s.a.v.s.: “Cili është më fatlumi i cili do ta fitojë shefaatin tënd në Ditën e Kijametit?” Muhamedi s.a.v.s. i thotë:

“O Ebu Hurejre e kam ditur se për këtë çështje nuk do të më pyes askush para teje, pasi që e kam vërejtur interesimin tënd për këtë çështje. Më fatlumi, i cili do ta fitojë shefaatin tim në Ditën e Kijametit do të jetë ai i cili thotë “La ilahe il-lallah” me zemër të singertë apo me shpirt të singertë”.

(Buhariu)

Muhsini pyet: “Po tjetër, çka mund të na thuash për singëritetin?” Imami thotë: “Duhet, që muslimani ta dijë çka është dyfaqësia dhe pasojat prej saj dhe të largohet nga ajo cilësi e keqe. Atëherë Hamdani ndërhyr dhe thotë: “Dëshmoj në Allahun se sot e tutje kurrë nuk do të krenohem për asnjë punë timen, nuk do ta proklamoj, nuk do ta tregoj me qëllim që punët e mija të jenë vetëm për Allahun. Më në fund, të gjithë shkuan nëpër shtëpitë e tyre, dhe të gjithë u ndanë të lumtur, dhe secili shpresonte, që punët e tij të jenë të singerta vetëm për Allahun.

SINQERITETI NË ZEKAT DHE SADAKA

I Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë: “Një njeri tha: ‘Do të jap sadaka’. Doli dhe e dha sadakanë në dorë të një hajni. Të nesërmen të tjerët thoshin: “Dje ky njeri i ka dhënë sadaka hajnit”. Ai thoshte në vetvete: “O Zoti im! Vetëm Ty të takon falënderimi (sadakanë e kam dhënë vetëm për Allahun)! Unë prapë do të jap sadaka”. Del nga shtëpia dhe i jep sadaka një prostitute. Të nesërmen njerëzit thoshin se ky njeri i ka dhënë sadaka prostitutës! Ai thoshte në vetvete: “O Zoti im! Vetëm Ty të takon falënderimi (sadakanë e kam dhënë vetëm për Allahun)! Unë prapë do të jap sadaka”. Kështu që del nga shtëpia dhe i jep sadaka një të pasuri. Të nesërmen njerëzit thoshin se ai i ka dhënë sadaka një të pasuri! Ai thoshte në vetvete: “O Zoti im! Vetëm Ty të takon falënderimi (sadakanë e kam dhënë vetëm për Allahun), për atë që i kam dhënë sadaka: hajnit, prostitutës dhe të pasurit!” Atij pastaj i paraqitet (në ëndërr) një thënie se: “Sadakaja e jote e dhënë hajnit ndikoi, që ai të largohet nga vjedhja; sadakaja e jote e dhënë prostitutës ndikoi, që ajo të largohet nga prostitucioni; sadakaja e jote e dhënë të pasurit ndikoi, që ai të ketë në konsideratë, dhe të shpenzojë (t’u japë të tjerëve) prej asaj çka i ka dhënë Allahu”.

(Transmeton Buhariu dhe Muslimi)

SINQERITETI I ZEJNUL ABIDINIT

Një pjesë e banorëve të Medinës ishin të varfër, mirëpo kur të varfrit zgjoheshin nga gjumi në mëngjes para derës së tyre gjenin ushqim. Ata interesoheshin ta dinin se kush ishte ai, por nuk mundën ta gjenin përplot dhjetë vite. Pas dhjetë vjetësh njëri prej banorëve të Medinës, i quajtur Zejnul Abidin, vdes. Kur të nesërmen në mëngjes, asnjëri prej tyre nuk kishte ushqim pranë shtëpisë së tyre, atëherë e kuptuan se ai, i cili ua sillte ushqimin kishte qenë Zejnul Abidin. Për ta vërtetuar edhe më shumë këtë, ata kur e morën ta pastrojnë trupin e tij e panë se shpina iu kishte nxirë, sepse ai me shpinën e tij e kishte bartur ushqimin dhe e kishte dërguar para dyerve të të varfërve.

“Kur të prezantojnë në pjesëtimin e pasurisë që ka lënë i vdekuri të afërm, bonjakë dhe varfanjakë (që nuk janë pjesëtarë në trashëgim), jepuani nga ajo (pasuri e lënë) dhe atyre thoni fjalë të mira. Le të frikësohen ata (në prag të vdekjes) sikur të linin pas vete pasardhës të paaftë, për të cilët kanë dro (si do të jetë gjendja e tyre) le t'i ruhen Allahut (dënimin të Tij) dhe le t'ju thonë (jetimëve) fjalë prindërore.”

(En-Nisa, 8-9)

SUHEJBI (R.A.)

Suhejbi ishte një djalë i mirë, bujar dhe fisnik. Fytyra e tij shkëlqente, kishte flokë të kuqe dhe ishte shumë i shkathët. Një ditë ushtria bizantine shkon dhe e zë rob në shtëpinë e tij. Pasi që e zë rob, ai rritet si skllavopronar, por pasi që rritet ikë dhe shkon në Mekë. Në Mekë filloi të merrej me tregti. Duke u marrë me tregti pasurohet shumë. Një ditë, derisa kthehej nga tregtia, dëgjon se Muhamedi, i biri i Abdullahut është dërguar Pejgamber dhe ka filluar t'i thërras njerëzit në besimin e të vetmit Zot. Kështu prej të parëve, që e kanë pranuar Islamin është edhe Suhejbi. Për shkak të Islamit është maltretuar shumë. Pasi që muslimanët migrojnë në Medinë, edhe Suhejbi vendos të migrojë. Kur e merr rrugën e migrimit, i shkojnë pas mekasit dhe e arrijnë atë në periferi të Mekës. Ai përgatit shigjetën dhe u thotë:

“Asnjë nuk mund të më afrohet derisa të më harxhohen të gjitha shigjetat, e pastaj e kam shpatën dhe nuk do të dorëzohem derisa të më punoj dora.”

Njëri prej mekasve i thotë:

“Ti ke ardhur në Mekë pa pasuri, ndërsa sot je prej më të pasurve.” Atëherë Suhejbi i thotë: “Po sikur t’ju lë tërë pasurinë time, a do të ma lironit rrugën?” “Po”- i përgjigjen.

Suhejbi i tregoi atyre ku e kishte pasurinë dhe ata shkuan, e morën pasurinë e tij dhe e lirojnë.

Suhejbit nuk iu dhimb pasuria, por kishte mallëngjim, që sa më shpejtë të takohej me të Dërguarin e Allahut. Ecte me të shpejtë, lodhej e nuk pushonte derisa e pa të Dërguarin e Allahut. Kur i Dërguari i Allahut s.a.v.s. i thotë Suhejbit:

“O Ebu Jahja, triumfoi pasuria jote.”

Atëherë filloi fytyra e Suhejbit të shkëlqejë dhe thotë: “Për Allahun ty nuk të ka treguar askush, pos Xhibrilit.”. Xhibrili e kishte zbritur ajetin kur’anor, shkak i të cilit ishte rasti i Suhejbit:

“Ka njerëz që flijojnë veten për të fituar kënaqësinë e Allahut, Allahu është shumë mirënjohës ndaj robërve të Vet”.

(El-Bekare, 207)

Sinqeriteti dhe sakrifica e Suhejbit duhet të jetë shembull për ne që të jemi të sinqertë në veprat tona dhe që ta fitojmë kënaqësinë e Allahut.

NAMAZI I PAPRANUAR

أَرَأَيْتَ الَّذِي يُكَذِّبُ بِالْإِيمَانِ (1) فَذَلِكَ الَّذِي يَدْعُ الْيَتِيمَ (2) وَلَا يَحْضُ عَلَى طَعَامِ الْمَسْكِينِ (3)
فَوَيْلٌ لِلْمُصَلِّينَ (4) الَّذِينَ هُمْ عَنْ صَلَاتِهِمْ سَاهُونَ (5) الَّذِينَ هُمْ يُرَاؤُونَ (6)
وَيَمْنَعُونَ الْمَاعُونَ (7)

“A e ke parë ti (a e sheh) atë, që përgënjeshtrojnë përgjegjësinë dhe llogarinë në botën tjetër?

Po ai është që e përzë në mënyrë të vrazhdë bonjakun.

Dhe që nuk nxit për ta ushqyer të varfrin.

Pra shkatërrim është për ata që falen,

Të cilët ndaj namazit të tyre janë të pakujdesshëm.

Ata që vetëm shtiren (sa për sy e faqe).

Dhe nuk japin as sendin më të vogël (as hua)”.

(El-Maun, 1-7)

I Dërguari i Allahut na ka tërhequr vërejtjen, që namazin mos ta falim vetëm për t’u proklamuar para njerëzve. Sepse namazi falet për të fituar kënaqësinë e Allahut, e jo për t’u krenuar para njerëzve apo për t’u lavdëruar para tyre.

Përderisa njëri falej në arë, disa djelmosha kalojnë pranë dhe thonë: “Sa mirë, ky njeri e ka lënë punën e arës dhe po falet”. Ndërsa, ai përderisa ishte në namaz u thotë:

“Unë, përpos që falem, jam edhe duke agjëruar” !!!

SINQERITETI SJELL SHPËTIM

Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: “Prej gjeneratave para jush, tre persona janë nisur për një udhëtim, deri sa i zë nata para një shpelle, në të cilën vendosen për ta kaluar natën. Nga kodra rrokulliset një shkëmb dhe e bllokoi tërësisht hyrjen dhe daljen e shpellës. (Ata duke biseduar mes vete) thonë: Ne nuk mund të shpëtojmë gjallë nga kjo shpellë ndryshe, vetëm se duke i bërë lutje Allahut të Lartmadhëruar, në bazë të punëve tona të mira.

Personi i parë prej tyre lutet: O Zoti im! I kam pasur prindërit shumë pleq dhe asnjëherë ujë nuk kam pirë para tyre, as nuk i kam dhënë familjes sime, po edhe punëtorëve të mi. Një ditë u vonova për shkak të kërkimit të kullës sa më të mirë, e kur u ktheva ata veç kishin fjetur. Pasi e mola bagëtinë, qumështin ua dërgova para tyre, por ata ishin fjetur. Unë nuk desha t’ua prish gjumin atyre, por edhe nuk e kam pirë qumështin para tyre, e as nuk i dhashë të pinë familjes dhe punëtorëve të mi. Qëndrova në këmbë zgjuar me qumështin në dorë duke i prituri deri sa të zgjoheshin. (Kështu prita) përderisa agoi dita, e fëmijët e mi qanin për qumësht para këmbëve të mia, e unë u dhashë të pinë qumësht, tek atëherë, pasi u zgjuan prindërit e mi dhe pinë para tyre. O Zoti im! Nëse këtë e kam bërë vetëm për të fituar kënaqësinë Tënde, na tejkaloni këtë fatkeqësi dhe lëvizni këtë shkëmb (e të dalim në dritë)! Shkëmbi lëvizi, por jo edhe aq sa mund të dilnin jashtë.

I dyti u lut: O Zoti im, kam pasur një kushërirë të afërm, të cilën e kam dashur më shumë se tërë botën (në një transmetim tjetër: Kam qenë aq fortë i dashuruar në të, ashtu siç i donë së tepërmi burrat gratë), andaj kërkova prej saj (siç kërkojnë meshkujt prej femrave), por ajo më refuzoi. Një vit prej viteve mbretëronte uri e madhe, e ajo u paraqiti tek unë. E unë ia dhashë asaj 120 dinarë ari, me qëllim që të pranojë të vetmohej me mua. Pasi i mori të hollat dhe e kisha në disponim (që të veprojmë me të çka të dua), ajo më tha: “Frikësoju Allahut, e mos ma prish virgjërinë padrejtësisht!”. Atëherë u largova prej saj dhe nuk kontaktova me të, edhe pse e doja më shumë se çdokënd tjetër, kurse të hollat, të cilat ia pata dhënë, nuk ia morra. O Zoti im, nëse këtë e kam bërë vetëm për ta fituar Kënaqësinë tënde, na shpëto nga kjo vështirësi, në të cilën gjendemi”. Shkëmbi prapë lëvizi (nga hyrja e shpellës), por jo në tërësi për të dalë nga aty.

Personi i tretë u lut: o Zoti im, unë kam pasur punëtorë dhe të gjithëve ua kam dhënë pagën e fitimit menjëherë, përpos një punëtori, i cili ka shkuar pa e marrë pagën (e fundit). Pastaj pagën e tij e kam vendosur në qarkullim dhe pasuria e tij u shtua. Pas një kohë me erdhi e më tha : “O rob i Allahut, më jep pagën!” I thash: “Krejt çka sheh prej kësaj pasurie, si: këto dele, këto lopë, këto deve dhe ky rob, të gjithë janë shtuar prej pagës tënde”. Ai më tha: “O rob i Allahut, mos u tall me mua!” Unë i thash: “Nuk jam duke u tallur me ty”. Pastaj e mori tërë pasurinë e tij dhe nuk la asgjë prej tyre. O Zot im, këtë e kam bërë vetëm e vetëm për ta fituar kënaqësinë Tënde; na shpëto nga kjo fatkeqësi! Atëherë shkëmbi lëvizi i tëri, dhe që të tre dolën nga aty, e shpëtuan.

(Buhari Dhe Muslimi)

FJALA E SINGERITETIT

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ

Një ditë prej ditësh i Dërguari i Allahut ishte ulur me sahabët e tij. Ai u thotë atyre:

*“Ai, i cili thotë **La ilahe il-lallah**, i singertë në thënien e tij, do të hyjë në xhenet.”*

Sahabët e pyesin: “Po ç’është singheriteti i asaj thënie, o i Dërguar i Allahut?” Muhamedi s.a.v.s. përgjigjet: *“Që të largohet nga ajo që e ka ndaluar Allahu.”*

Për këtë arsye fjala **La ilahe il-lallah** kërkon që ajo të thuhet me singheritet të pastër, me zemër, duke mos i bërë ortak Allahut dhe ibadet të bëhet vetëm për Allahun, sepse Allahu i pranon veprat që bëhen me singheritet ndaj Tij.

Në një hadith Muhamedi s.a.v.s. ka thënë:

*“Çdo herë kur robi (njeriu) thotë **La ilahe il-lallah** me singheritet, i hapen atij dyert e qiejve deri te Arshi i madh dhe nëse largohet prej mëkateve të mëdha.”*

DY DINARËT

Një beni Israil dëgjon se një popull e adhuronte një pemë. Ky njeri hidhërohet dhe e merr sëpatën, që të shkojë dhe ta pres atë pemë. Në mes të rrugës, në formë të një njeriu të moshuar i paraqitet shejtani dhe e pyet:

- Ku po shkon?
- Që ta pres një pemë.
- Po pse po e pret?
- Sepse po e adhuron ky popull.

Në atë moment shejtani në formë njeriu ndeshet me të, mirëpo ngadhënjimtar del beni Israili. Mirëpo, shejtani përdor një metodologji tjetër, duke i thënë atij: “Nëse nuk e prenë atë pemë për çdo ditë do të t’i jap nga dy dinarë”.

Në ditën e parë dhe të dytë njeriut në shtëpi i vijnë nga dy dinarë, ndërsa në ditën e tretë jo. Atëherë bini Israili hidhërohet përsëri dhe e merr sëpatën, që të shkojë ta presë pemën në mes të rrugës, prapë i del shejtani në formë të njeriut, që ta pengojë. Ata ndeshen, mirëpo kësaj radhe shejtani del fitimtar. Njeriu i thotë: “Si është e mundur? Përse tash ti dole fitimtar?” Sepse herën e parë ke qenë i singertë dhe singëriteti ka qenë, që t’i je nisur ta presësh pemën vetëm për Allahun, ndërsa tani ti je nisur ta presësh pemën për shkak të dy dinarëve. E për këtë shkak fitova, e ti humbe”.

IDHUJTARIA E FSHEHTË

Ebu Musa Esh'ariu, është njëri prej shokëve të ngushtë të Pejgamberit s.a.v.s., një ditë prej ditësh, përderisa mbante një fjalim para njerëzve, thotë: “O ju njerëz, ruajuni nga idhujtaria e fshehtë, se ky lloj idhujtarie është më e fshehtë se hapat e buburrecit”.

Dy njerëz nuk u pajtuan me këtë fjalim dhe i thonë se do të ankohe mi te emiri i besimtarëve – Omeri r.a., përderisa nuk na sjell argument. Atëherë Ebu Musa Esh'ariu thotë: “Një ditë i Dërguari i Allahut s.a.v.s. na ka mbajtur një fjalim dhe ka thënë:

“O ju njerëz, ruajuni nga idhujtaria e fshehtë, se ky lloj idhujtarie është më i fshehtë se hapat e buburrecit.”

Shokët i thanë: “O i Dërguar i Allahut, po si të ruhemi nga ky lloj idhujtarie, përderisa është aq i fshehtë si hapat e buburrecit?” Pejgamberi s.a.v.s. thotë:

“Bëjeni këtë lutje: O Zoti ynë, kërkojmë mbrojtje prej Teje nga çdo lloj idhujtarie, të cilën e dimë, dhe kërkojmë falje për ato që nuk i dimë”.

MUHAXHIRI I UMI KAJ SIT

Një banor i Mekës dëshironte të martohej me një vajzë fisnike të fisit kurejsh, e cila quhej Umi Kajs. Mirëpo, familja e saj nuk pranojnë. Pastaj Umi Kajs pranon Islamin. Kur muslimanët në vitin 622 bëjnë hixhretin prej Mekës në Medine, edhe ajo Umi Kajs në Medine. Pas saj në Medine hixhretin e bën edhe ai, duke lakmuar se atje do të ketë mundësi ta fejojë dhe të martohet me të. Për këtë arsye sahabët e quanin Muhaxhiri i Umi Kajsit. Sepse ai e ka bërë hixhretin për t'u martuar me të, e jo për Allahun dhe për të Dërguarin e Tij.

Për këtë Muhamedi s.a.v.s. ka thënë:

“Veprat shpërblehen sipas qëllimit. Çdo njeri shpërblehet për veprën e tij se për çka e ka vendosur ta bëjë atë vepër. Nëse hixhreti i ndonjërit është për Allahun dhe të Dërguarin e Tij, atëherë edhe shpërblimi i atij hixhretit bëhet shpërblim për Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Po nëse ndonjëri e ka bërë hixhretin, që të përfitojë diçka në këtë botë apo për t'u martuar me ndonjë grua, atëherë edhe shpërblimi i atij hixhreti është për atë qëllim”.

SHKAKU I TË QAJTURIT

Një ditë prej ditësh Omer bin El-Hatabi r.a. hyri në xhami, kur befas e sheh Muadh bin Xhebelin r.a. duke qarë.

Omeri r.a. e pyet: - Përse po qan?

Muadhi i përgjigjet: - Kam dëgjuar një hadithë të të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. duke thënë:

“Proklamimi i lehtë është idhujtari. Kush armiqësohet me dashamirët e Allahut, Allahu i shpallë luftë. Vërtet Allahu i do të devotshmit e padukur, të cilët edhe nëse nuk janë prezent janë prezent (me vepër), e nëse janë prezent nuk njihen. Zemrat e tyre janë drita shkëlqimi të udhëzimit.”

Më të dashurit të Allahut janë të sinqertit.

ÇLIRUESI I KËSHTJELLËS

Në kohën e hilafetit të Omer bin Hatabit r.a. muslimanët e kishin rrethuar një kështjellë të armikut. Udhëheqës ishte Sead Ibn Vekas r.a. Ushtria muslimane tentonte të depëronte në brendi por kështjella ishte e fortifikuar me një mur të gjerë, të lartë dhe të gjatë. Kështu ata nuk mund të hynin. Tentuan në ditën e parë, por pa sukses; tentuan në ditën e dytë, pa sukses; tentuan edhe ditën e tretë, por pa sukses.

Në ditën e katërt para sabahut një ushtar kishte marrë abdest, i kishte falur dy rekate namaz, kishte depërtuar në brendësi, pasi kishte hapur një vrimë dhe i kishte thyer dyert e derës dhe i kishte hapur dyert e kështjellës thërret: “Ejani, ejani! Kur ushtria muslimane e dëgjoi zërin atëherë me shpejtësi u tubuan dhe depërtuan në kështjellë dhe e çliruan.

Pas përfundimit të betejës, Seadi thërret. Ku është çliruesi i kështjellës, asnjëri nuk lajmërohet. Atëherë Seadi thotë: Jam përbetuar në Allahun, se patjetër do ta takoj dhe dëshiroj që në mbrëmjet të vjen në tendën time.

Kur në mbrëmje një ushtar me fytyrë të mbuluar shkon te tenda e Seadit, kërkon leje dhe hyn në të. Seadi i thotë: - A ju jeni çlirues i kështjellës? I përgjigjet: - Po. – Atëherë zbuloje fytyrën tënde. Ai i thotë: - Unë e zbuloj fytyrën, por me tre kushte. – Urdhëro, cilat janë ato tre kushte?

Ushtari i thotë: - Që mos ta dijë askush tjetër, pos teje.

E dyta: - Që të mos më shpërblesh dhe të mos gradohem. Dhe që edhe ti mos të më pyesësh për emrin tim.

Seadi i pranoi kushtet, ndërsa ushtari e zbuloi fytyrën, e Seadi e njohu fytyrën e tij. Pastaj ushtari doli nga dera me punën e tij të singertë, të cilën e kishte bërë vetëm për Allahun.

MONEDHA FALSE

Një plak shkon në treg për të blerë sende për nevojat e tij. Kur hyn në shitore ia jep monedhën. Shitësi e merr monedhën, e shikon plakun dhe i thotë: - O axhë, sa po shoh në fytyrën tënde e kuptoj se jeni shumë i ndershëm dhe fisnik. Prej nga e keni marrë këtë monedhë? Plaku u befasua dhe i tha shitësit: - Po çfarë ka lidhje fisnikëria ime me monedhën?!

Shitësi i thotë: - të lutem më trego se ku e ke marrë këtë monedhë.

Dje kam punuar në një vend dhe kjo është monedha që e kam fituar me djersën time.

Shitësi i thotë: - Po, a e dini se kjo monedhë është false?

Plaku i thotë: - Jo.

Pastaj plaku e pyet: - Pse, a me të vërtetë është monedhë false?

Shitësi i thotë: - Po.

Para se ta përfundojë fjalën plakut i bie të fikët dhe e humb vetëdijen.

Shitësi mundohet t'ia kthejë vetëdijen, aty tubohen njerëz. Njëri prej njerëzve i hedh ujë plakut e atij i vjen vetëdija. Atëherë shitësi brengoset dhe i thotë: - Merr çfarë të nevojitet. Njerëzit e pyesin: - Çka ishte puna me ty? Ai u thotë: - Kur më tha shitësi se monedha është false, menjëherë m'u kujtua sikur para meje është Allahu i Lartmadhëruar dhe Ai duke m'i kthyer veprat e mia duke më thënë: - Këto vepra tua janë false, veprat e tua nuk kanë pasur sinqeritet. Dhe nga ky kuptim më ka rënë të fikët.

Kështu ne duhet të mundohemi, që të veprojmë me sinqeritet dhe veprat tona mos të jenë të falsifikuara.

ÇKA PËRFUNDOJMË PREJ KËTIJ LIBRI

- Të gjithë jemi të urdhëruar që veprat t'i kryejmë me sinqeritet.
- E kundërta e sinqeritetit është dyfytësia.
- Shejtani nuk mund t'i përvetësojë asnjëherë të sinqeritetit.
- Sinqeriteti është shkak për të fituar shefaatin e Pejgamberit s.a.v.s.
- Veprat shpërblehen sipas qëllimit.
- Më të dashurit e Allahut janë më të sinqeritetit.
- Duhet të kemi kujdes dhe të ruhem nga idhujtaria e fshehtë.

PËRFUNDIM

Të kujtojmë se veprat shpërblehen sipas qëllimit, e ne duhet t'i kryejmë veprat me sinqeritet, se sinqeriteti është shkak për të fituar shefaatin e Pejgamberit s.a.v.s. Ndërsa përkujtimi është për ata që kanë zemër, përqendrojnë dëgjimin dhe dëshmojnë me sy të vërtetën.

Ndoshta kjo çka është shkruar në këtë libër i bën dobi zemrës tënde fëmijë i dashur, e dëgjon veshi yt dhe dëshmon me tërë qenien tënde atë që është shkruar.